

Support to Electoral Reforms  
in the Western Balkans



# Pjesëmarrja në zgjedhje e personave me aftësi të kufizuara dhe në administratën zgjedhore në Maqedoninë e Veriut

Përmbledhje e aktivitetit

Foto: Steven HWG / Unsplash



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Me financim nga



Austrian  
Development  
Agency

Vlerësimi i Pjesëmarrjes në Zgjedhje të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe në Administratën Zgjedhore në Maqedoninë e Veriut, i realizuar nga nëntori 2021 deri në gusht 2022, analizon dhe jep rekomandime për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara nga këndvështrimi i veprimtarisë së administratës zgjedhore.

Ky studim është rezultat i një përpjekjeje bashkëpunuese midis projektit "Mbështetje për reformat zgjedhore në Ballkanin Perëndimor" të Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), financuar nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) në kuadër të projektit "Mbështetje për reformën zgjedhore në Maqedoninë e Veriut", të Qeverisë së Zvicrës.

Si kuadër vlerësimi për këtë studim shërbeu Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), të cilën Maqedonia e Veriut e ka ratifikuar në vitin 2011, si dhe angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe rekomandimet e mëparshme të misioneve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Studimi përfshiu 48 intervista, 2 anketa me secilin prej 100 zyrtarëve zgjedhorë, 11 diskutime në fokus grupe (kryesisht me persona me aftësi të kufizuara dhe me përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara (OPAK), si dhe analizimin e dokumentacioneve ekzistuese. Në raport ofrohen 33 rekomandime, nga të cilat 19 janë për KSHZ-në, kurse 14 për organet tjera.

## **PËRPJËKJET E DERITANISHME**

Deri më sot, KSHZ-ja ka ndërmarrë disa iniciativa pozitive për të rritur përfshirjen dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, duke e bërë informacionin më të aksesueshëm dhe duke përmirësuar aksesin në ditën e zgjedhjeve. Këto iniciativa përfshijnë përgatitjen, bashkë me shoqërinë civile, të një harte për të parë aksesueshmërinë e qendrave të votimit, sigurimin e 134 rampave në qendrat e votimit (shpesh shkolla, duke i bërë kështu shkollat më të aksesueshme për nxënësit dhe për mësuesit me aftësi të kufizuara) dhe futjen në përdorim të një shablloni Braille për t'u përdorur për shenjimin e fletëve të votimit nga zgjedhësit e verbër ose zgjedhësit me shikim të kufizuar. KSHZ-ja ka prezantuar edhe një linjë telefonike falas në një format të aksesueshëm, ku personat me aftësi të kufizuara shqisore mund të komunikojnë përmes videove me KSHZ-në. Në disa takime të KSHZ-së ka të pranishëm përkthyes të gjuhës së shenjave, faqja e saj e internetit është më e aksesueshme dhe KSHZ-ja ka përfshirë në grupin e saj të trajnerëve edhe disa trajnerë për çështjet e aftësisë së kufizuar. KSHZ-ja ka nënshkruar gjithashtu edhe një Memorandum Bashkëpunimi me OPD Inkluziva që mbulon ndërgjegjësimin e komisionerëve të KSHZ-së dhe stafit të zyrës qendrore.

## **GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIMET**

Sfidat në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje i shtojnë edhe më shumë vështirësitë me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, duke i bërë njerëzit të ndihen të poshtëruar dhe të diskriminuar, sipas të anketuarve. Ata vunë në dukje mungesën e një mjedisi favorizues, strategjinë e vjetruar kombëtare për aftësitë e kufizuara, dominimin e vazhdueshëm të një modeli mjekësor dhe bamirës, mungesën e të dhënave për aftësitë e kufizuara dhe njohuritë e pakta për KDPAK dhe për parimet e saj. Ata gjithashtu theksuan se vështirësitë në pjesëmarrjen në zgjedhje janë veçanërisht të theksuara për gratë dhe për personat me aftësi të kufizuara nga grupet etnike jo-shumicë.

Vlerësimi doli me rekomandimin që KSHZ-ja duhet të krijojë një politikë gjithëpërfshirëse për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara, sa më shpejt të jetë e mundur dhe përpara zgjedhjeve të ardhshme, bazuar në rekomandimet e KDPAK-së dhe ODIHR-it dhe të hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës me organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe me palët e tjera të interesuara.

Sfidat rreth **aksesueshmërisë së partive politike dhe strukturave të tyre të brendshme** komprometojnë aftësinë e personave me aftësi të kufizuara për të kandiduar, për të bërë zgjedhje të informuara, për t'u organizuar dhe për të marrë pjesë në jetën politike.

Përveç kësaj, gjetjet tregojnë se personat me aftësi të kufizuara nuk janë të përfaqësuar sa duhet në mbulimin mediatik të zgjedhjeve, pasi çështjet e aftësisë së kufizuar ngrihen rrallë dhe programet mbi aksesueshmërinë janë të pamjaftueshme. Kjo çon në vazhdimësinë e marxhinalizimit dhe stereotipeve negative, duke i lënë personat me aftësi të kufizuara në rrezikun e shkëputjes dhe mosinformimit sa duhet që të mund të vendosin se për kë duan të votojnë në zgjedhje. Vlerësimi rekomandoi që partitë politike duhet të ndërmarrin disa hapa në rregulloret dhe politikat e tyre të brendshme, si për shembull duke i shtjelluar më tej politikat e tyre partiake për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në strukturat drejtuese dhe ekzekutive brendapërbrenda partive dhe në listat e kandidatëve, si dhe duke ndërmarrë përpjekje për të siguruar aksesueshmëri në zyrat e partive, në informacione dhe në takime.

**Kuadri ligjor** për zgjedhjet duhet të përfshijë dispozita të qarta për personat me aftësi të kufizuara dhe të harmonizohet me detyrimet e përcaktuara nga KDPAK-ja për të parandaluar përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale ose psikosociale. Grupet e mëparshme të punës për rishikimin e Kodit Zgjedhor të Maqedonisë së Veriut i kanë përfshirë përfaqësuesit e organizatave të personave me aftësi të kufizuara vetëm në baza ad hoc. Vlerësimi rekomandoi që personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre duhet të konsultohen sistematikisht në proceset e ardhshme legjislative.

Falë iniciativave të KSHZ-së, **informacioni mbi proceset zgjedhore është tani më i aksesueshëm** për personat me aftësi të kufizuara dhe për ata që janë të përfshirë në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, pjesëmarrësit e fokus grupeve vunë në dukje disa mangësi dhe vështirësi në aksesin në informacionin e KSHZ-së dhe një mungesë ndërgjegjësimit në politikat dhe veprimet e KSHZ-së.

Vlerësimi rekomandoi që KSHZ-ja duhet të zhvillojë më tej sigurimin e informacionit, edukimin e zgjedhësve dhe politikat e komunikimit me zgjedhësit për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara, si dhe besimin tek institucionet. Vlerësimi rekomandoi që zbatimi i iniciativave të KSHZ-së për të përmirësuar **aksesin në ditën e zgjedhjeve** duhet të vazhdojë dhe të avancojë dhe se KSHZ-ja duhet të rishikojë mënyrën e votimit për të identifikuar të tjera përmirësime të mundshme. Megjithëse mungesa e aksesit fizik të pavarur në qendrat e votimit mbetet sfiduese dhe ka nevojë për angazhim të mëtejshëm me autoritetet përkatëse, KSHZ-ja duhet të shqyrtojë mundësitë dhe opsionet për votim në objektet rezidenciale të përkujdesjes për personat me aftësi të kufizuara, siç bën për të moshuarit në objekte të tilla. Votimi në shtëpi ofron mundësi të shtuara për pjesëmarrje; megjithatë, theksi parësor duhet të vihet tek maksimizimi i aksesit në qendrat e votimit.

## HAPAT E ARDHSHËM

Nevojiten masa specifike për të ofruar de facto **mundësi të barabarta** që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë plotësisht në zgjedhje. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij vlerësimi i ofrojnë KSHZ-së dhe institucioneve dhe organizatave të tjera një sërë hapash për t'u ndërmarrë në të ardhshmen, duke përfshirë edhe disa plane tëmundshme veprimi. Kontribuuesit në këtë raport janë të përkushtuar të monitorojnë ndryshimet që rezultojnë nga ky raport, si dhe të mbështesin palët e interesuara që do të punojnë drejt zbatimit të rekomandimeve. Ky raport do të ofrojë bazën për organizimin e një sërë tryezash të rrumbullakëta me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në nivel lokal dhe qendror për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe për të nxitur veprime avokuese.

Për të mësuar më shumë, vizitoni: [www.osce.org/odihr/wb](http://www.osce.org/odihr/wb)

*Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve, projekteve apo zbatuesve të tyre.*

